




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04 - 0049245/ dt. 16.07.2020
Mitrovicë / 26

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, në koordinim me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, sjell këtë:


V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Verifikimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Kontratave për Pronat e Paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. Formohet Komisioni për Verifikimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Kontratave për Pronat e Paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Xhevdet Aruqaj – kryetar, (DPU);
 - 1.2. Donjeta Maxhuni – anëtare (DBF);
 - 1.3. Ruzhdi Ujkani – anëtar, (DGJKP);
 - 1.4. Merita Preteni – anëtare (Sekretaria e K.K.);
 - 1.5. Bedri Murati – anëtar (DEZHTIE).
2. Komisioni i lartcekur obligohet që të bëjë verifikimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave për pronat e paluajtshme të Komunës së Mitrovicës së Jugut të cilat janë dhënë në shfrytëzim për periudhë më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vite deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.
3. Komisioni do të verifikoj dhe monitoroj të gjitha kontratat të cilat përfshihen në listën e kontratave për pronat e paluajtshme të Komunës që gjenden në shfrytëzim, të siguruar nga Drejtoria përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e këtyre kontratave.
4. Komisioni bazë për punën e tij do të ketë: Ligji nr. 06/L092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe aktet ligjore

dhe nënligjore në fuqi nga fusha përkatëse, përfshirë çdo akt i cili është pjesë përbërëse e lëndëve-kontratave respektive.

5. Pas përfundimit të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim, Komisioni obligohet që të hartoj Raport me Shkrim për çdo kontratë vec e veç, përfshirë konkluzione, duke përshkruar gjendjen faktike dhe të njëjtët t'ia dorëzoj Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës.
6. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat 2 vjeçar.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

1x1 Email: Propozimi për formimin e komisionit për trajtimin e nevlit të zbatueshmërisë së kontratave të dhëna përmes Kuvendit Komunal të Mitrovicës, i datës 07.07.2026 nga Kabineti i Kryetarit.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Drejtorive përgjegjëse (DPU dhe DGJK)
- 1x1 Zyres Ligjore
- 1x1 Zyres për Informim
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

